



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 8.

Prishtinë, më 20.12.2017 në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-204

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Zenun Pajaziti, Fitore Pacolli, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku dhe Milaim Zeka.

Munguan: Armend Zemaj, Adem Hoxha dhe Glauk Konjufca.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerr: Përfaqësuesi nga GLPS, GIZ, OSBE-së, NDI, KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi znj. Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja-Blerta Deliu Kodra pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit me këtë:

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së.

Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, përveç pjesës tekstuale përmban edhe pjesën tabelore që përfshinë të dhënat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2018.

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka paraqitur raportin me 101 amendamente.

Sa i përket legjislacionit të Bashkimit Evropian, çështja e buxhetit të shteteve anëtare nuk është pjesë e rregullimit të legjislacionit të përbashkët, por është kompetencë e brendshme e shteteve anëtare.

Andaj, konstatohet se Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, së bashku me amendamentet e komisionit Funkcional, nuk rregullohen me legjislacionin të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryetarja hodhi në votim Projektligjin me raportin me amendamente dhe pas votimit konstatoi se me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

Miratohet Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, me amendamentet e Komisionit Funkcional, me konstatimin se nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, këto çështje nuk janë të rregulluara me legjislacionin e BE-së, por mbeten kompetencë e brendshme e shteteve anëtare.

3. Të ndryshme

Kryetarja, lidhur me këtë pikë, njoftoi për ftesën që ka ardhur në komision, për pjesëmarrje në COSAC, që mbahet në Sofje të Bullgarisë dhe marrim pjesë në cilësinë e vëzhguesit prej 21-22 janar, andaj në takimin e radhës do vendosim se kush do të marrë pjesë.

Ilir Deda, lidhur me COSAC-un tha se në 3 vjet mundohemi me u anëtarësuar dhe propozoi që stafi me treguar ku është pozicioni, se çfarë ka ndodhur, kush po na shtyn përpara, e kush po na bllokun dhe në një mbledhje të veçantë të diskutojmë për këtë çështje.

Kryetarja u ndërlidh në diskutimin e parafolësit dhe kërkoi nga stafi që të përgatitet një material se ku jemi me procedurë dhe deri ku ka shkuar Kosova në COSAC dhe në COSAC në pjesëmarrjen e saj.

Në fund kryetarja propozoi që pasi është fundi i vitit, të caktohet një ditë për një drekë pune së bashku me stafin. Anëtarët e komisionit u pajtuan dhe u vendos që stafi të njoftojë për kohën dhe vendin se ku do të takohen.

Mbledhja përfundoi në orën 9:20.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit

Kryetare e komisionit,

Znj. Blerta Deliu-Kodra